



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

DIAGNOSTIKIM-MENAXHIM NË AUTOSERVIS

Niveli i pestë në KSHK¹, referuar nivelit V të KEK²

M1-V-23

Tiranë 2023

¹Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Diagnostikim-menaxhim në autoservis”		Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli V në KSHK, referuar nivelit V të KEK	M1-V-23
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i arsimimit profesional në drejtimin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis” niveli V në KSHK, referuar nivelit V të KEK, është <i>përgatitja e individëve e për t’u punësuar apo vetëpunësuar në profesione që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e ofruara në fushën e diagnostikimit dhe menaxhim në autoservis.</i>		
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	<p>Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në drejtimin “Diagnostikim-menaxhim në autoservis” niveli V në KSHK, referuar nivelit V të KEK, kanë të drejtë të hyjnë të gjithë individët që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kanë përfunduar me sukses shkollat e mesme profesionale “Shërbime mjetes transport”, niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK - kanë përfunduar arsimimin në niveli IV në KSHK, referuar nivelit IV të KEK dhe kanë njohuri dhe përvojë pune, të paktën pesë vjet, të vërtetuar në fushën e shërbimeve të mjeteve të transportit - jenë në kushte shëndetësore që të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. <p>Pranohen dhe individë me aftësi ndryshe, kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, institucionet përgjegjëse përgatit udhëzime të veçanta me kriteret e posaçme pranimit për këto shkolla</p>		
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	<p>Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Diagnostikim-menaxhim në autoservis” niveli V në KSHK, referuar nivelit V të KEK, e pajis individin me certifikatën dhe suplementin përkatës të këtij niveli për diagnostikim-menaxhim në autoservis, të njohur në territorin e Republikës së Shqipërisë..</p> <p>Ky kualifikim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës si diagnostikues i parregullsive të automjeteve të lehta dhe si menaxher në subjekte të shërbimeve të mjeteve të ndryshme të transportit, në njësi servisi të mjeteve të ndryshme të transportit, të shitjes së pjesëve të ndërrimit, të mekanikës bujqësore, në zyrat përkatëse për trafikun rrugor, në kompanitë e transportit ose kompanitë e sigurimit, si dhe në veprimtari të tjera që veprojnë në këtë drejtim. Gjithashtu, nxënësi mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve të transportit,</p>		
Data e validimit	<i>Maj 2023</i>		
Data e miratimit			
Variantet e mëparshme	M1-V-10		

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI

Individi duhet të dijë:

Automjetet, ndërtimi dhe funksionimi i sistemeve kryesore të tyre

- Të klasifikojë mjetet e transportit sipas parametrave strukturor të automjeteve me MDB, me lëndë djegëse alternative, Hibride dhe Elektrike;
- Të përshkruajë karakteristikat teknike dhe funksionale të automjeteve me MDB, me lëndë djegëse alternative, Hibride dhe Elektrike;
- Të përshkruajë performancën e funksionimit të automjeteve;
- Të përshkruajë shpërndarjen e forcës dhe e peshës së automjetit;
- Të përshkruajë sistemet mekanike, ndërtimin dhe përdorimin e tyre në automjeteve;
- Të përshkruajë sistemet elektrike, elektromekanike, elektronike dhe skemat përkatëse, ndërtimin dhe përdorimin e tyre në automjeteve;
- Të përshkruajë sistemet pneumatike, hidraulike, ndërtimin dhe përdorimin e tyre në automjeteve;
- Të përshkruajë komandimin elektronik dhe kompjuterik të funksionimit të automjeteve;
- Të listojë pjesët dhe komponentët kryesore të automjeteve;
- Të përshkruajë sistemet e sigurisë aktive dhe pasive;
- Të përshkruajë sistemet e komforti dhe ndihmës të drejtuesit;

Diagnostikimi në sistemet elektrike, elektronike dhe mekatronike në automjete, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.

- Të përshkruajë përdorimet e elektroteknikës, elektronikës dhe mekatronikës, dhe rëndësinë e tyre për mjetet e transportit;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e burimeve të energjisë elektrike në mjetet e transportit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në sistemin e furnizimit me rrymë elektrike të automjeteve;
- Të listojë dallimin midis përcjellësve dhe izolatorëve të rrymës elektrike;
- Të përshkruajë veçoritë dhe përdorimet në automjete të elementeve kryesore të skemave elektrike (çelësave, rezistencave, bobinave, kondensatorëve, ndriçuesve dhe sinjalizuesve);
- Të përshkruajë veçoritë dhe përdorimet në mjetet e transportit të elementeve kryesore të skemave elektrike (pajisjeve treguese të parametrave mbrojtëse, komutuese, komanduese dhe rregulluese);
- Të shpjegojë dukuritë e elektromagnetizmit dhe induksionit elektromagnetik;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe ndërtimin e pajisjeve elektrike;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe ndërtimin e transformatorëve të ndryshëm;
- Të listojë elementët elektronikë;
- Të shpjegojë simbolikën dhe përdorimet e tyre në mjetet e transportit;
- Të përshkruajë veçoritë dhe përdorimet në mjetet e transportit të qarqeve të integruara;

- Të përshkruajnë, llojet, veçoritë dhe përdorimet në mjetet e transportit të sensorëve, procesorëve dhe vepruesve (aktuatorëve);
- Të përshkruajnë llojet, veçoritë dhe përdorimet e sistemeve të komandimit automatik në mjetet e transportit;
- Të listojë veglat, pajisjet dhe instrumentet që përdoren për diagnostikimin e sistemit elektrik, elektronik dhe mekatronik;
- Të përshkruajë matjet dhe kontrollet për diagnostikimin dhe mjetet përkatëse;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të të dhënave nga diagnostikimi i sistemeve elektrike dhe elektronike në automjete;
- Të shpjegojë mënyrën e leximit dhe interpretimit e informacionit nga sistemi kompjuterik për parregullsitë në sistemin elektrik dhe elektronik;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të radhës së punës për riparime ose/dhe për zëvendësime;
- Të shpjegojë procedurat e riparimit të parregullsive të diagnostikuara ose/dhe për zëvendësime të elementëve jo funksional;
- Të përshkruajë rëndësinë e provës së kontrollit dhe testimit pas riparimit;

Diagnostikimi në motorët dhe sistemeve ndihmëse të tij, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre

- Të përshkruajë karakteristikat teknike të motorëve me naftë dhe benzinë, me lëndë djegëse alternative dhe hibride/elektrike;
- Të përshkruajë funksionimin dhe ndërtimin e motorëve, si dhe të sistemeve, mekanizmave dhe komponentëve që lidhen me funksionimin e tyre;
- Të rendisë parregullsitë kryesore të sistemeve dhe mekanizmave të motorëve të automjeteve;
- Të përshkruajë shkaqet më të mundshme të parregullsive të sistemeve dhe mekanizmave të motorëve të automjeteve;
- Të listojë veglat, pajisjet dhe instrumentet që përdoren për diagnostikimin e sistemeve dhe mekanizmave të motorëve të automjeteve.
- Të tregojë cilat janë mënyrat e dhënies së informacionit nga sistemi kompjuterik për parregullsitë e motorit të automjetit që diagnostikohet;
- Të shpjegojë mënyrën e leximit dhe interpretimit e informacionit nga sistemi kompjuterik për parregullsitë e motorit të automjetit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në sistemin e ndezjes së përzierjes djegëse të automjeteve;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në sistemin e lëshimit të motorit të automjeteve;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsitë në trupin e motorit;
- Të shpjegojë mënyrat e diagnostikimit në motorët e automjeteve në bazë të informacionit të prodhuesit dhe interpretimi i rezultateve;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në mekanizmin bjellë –manivelë dhe në mekanizmin e gazshpërndarjes të motorit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në sistemin e ftohjes dhe vajosjes së motorit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në sistemin e furnizimit me ajër me presion dhe turbo kompresor;

- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në sistemet e ushqimit të motorit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive të sistemeve të trajtimit të gazrave dhe të shkarkimit;
- Të përshkruajë matjet dhe kontrollet për diagnostikimin;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të të dhënave nga diagnostikimi në motor;
- Të shpjegojë procedurat e sigurisë në lidhje me ndërhyrjet në motorët me lëndë djegëse alternative;
- Të shpjegojë procedurat e sigurisë në lidhje me ndërhyrjet në automjetet elektrike dhe hibride me teknologji të tensionit të lartë;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të radhës së punës për riparime ose/dhe për zëvendësime;
- Të shpjegojë procedurat e riparimit të parregullsive të diagnostikuara ose dhe për zëvendësime të elementëve jo funksional;
- Të përshkruajë rëndësinë e provës së kontrollit dhe testimit pas riparimit;
- Të shpjegojë procedurat e mirëmbajtjes sipas udhëzimeve të prodhuesit;

Diagnostikimi i sistemit të transmetimit të fuqisë në automjet

- Të përshkruajë karakteristikat teknike, të elementeve të transmetimit të fuqisë së automjeteve, funksionimin e ndërimitin e tyre;
- Të rendisë parregullsitë kryesore të elementeve të transmetimit të fuqisë së automjeteve;
- Të përshkruajë shkaqet më të mundshme të parregullsive të elementeve të transmetimit të fuqisë së automjeteve te automjetet e lehta
- Të listojë veglat, pajisjet dhe instrumentet që përdoren për diagnostikimin e sistemit të t të transmetimit të fuqisë në automjet;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në friksion dhe elementëve të komandimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në kutinë e ndërrimit të shpejtësisë manuale dhe elementëve të komandimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në kutinë e ndërrimit të shpejtësisë gjysmë automatike dhe automatike dhe elementëve të komandimit të tyre;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në reduktorin shpejtësisë;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në transmisionet kardanike;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në transmisionin kryesor dhe diferencial;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në gjysmëboshte (semiakse);
- Të përshkruajë matjet dhe kontrollet për diagnostikimin;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të të dhënave nga diagnostikimi i sistemit të transmetimit të fuqisë së automjeteve;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të radhës së punës për riparime ose/dhe për zëvendësime;
- Të shpjegojë procedurat e riparimit të parregullsive të diagnostikuara ose/dhe për zëvendësime të elementëve jo funksional;
- Të përshkruajë rëndësinë e provës së kontrollit dhe testimit pas riparimit;
- Të shpjegojë procedurat e mirëmbajtjes sipas udhëzimeve të prodhuesit;

Diagnostikimi i sistemit të frenimit të automjetit

- Të përshkruajë karakteristikat teknike të sistemit të frenimit të automjeteve, funksionimin dhe ndërtimin e tyre;
- Të rendisë parregullsitë kryesore të elementëve të llojeve të ndryshme të sistemeve të frenimit të automjeteve;
- Të përshkruajë shkaqet më të mundshme të parregullsive të elementëve të llojeve të ndryshme të sistemeve të frenimit të automjeteve
- Të listojë veglat, pajisjet dhe instrumentet që përdoren për diagnostikimin e sistemit të frenimit të automjetit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në mekanizmin e komandimit të frenave.
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në sistemet e frenave me disk, me tambur ose të kombinuar dhe frenave stacionare (të dorës) së automjetit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive të një sistemi me ABS, ESP etj.;
- Të përshkruajë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive të sistemeve të frenimit elektrohidraulik (EHB) dhe elektrik (EMB);
- Të përshkruajë kontrollet dhe matjet për diagnostikimin e sistemit të frenimit të automjeteve;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të të dhënave nga diagnostikimi i sistemit të frenimit të automjetit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të radhës së punës që ndiqet për riparime ose/dhe për zëvendësime;
- Të shpjegojë procedurat e riparimit të parregullsive të diagnostikuara ose/dhe për zëvendësime të elementëve jo funksional;
- Të përshkruajë rëndësinë e provës së kontrollit dhe testimit pas riparimit;
- Të shpjegojë procedurat e mirëmbajtjes sipas udhëzimeve të prodhuesit;

Diagnostikimi i sistemit të drejtimit të automjetit

- Të përshkruajë karakteristikat teknike të sistemit të drejtimit të automjeteve, funksionimin dhe ndërtimin e tyre;
- Të rendisë parregullsitë kryesore të elementeve të sistemeve të drejtimit të automjeteve;
- Të përshkruajë shkaqet më të mundshme të parregullsive të elementeve të sistemeve të drejtimit të automjeteve;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në mekanizmin e komandimit të sistemit të drejtimit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në sistemin e drejtimit me grup timoni hidraulik dhe pompë hidro-elektrike dhe motor elektrik;
- Të përshkruajë kontrollet dhe matjet për diagnostikimin e sistemit të drejtimit të automjetit;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të të dhënave nga diagnostikimi i sistemit të drejtimit të automjetit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të radhës së punës që ndiqet për riparime ose/dhe për zëvendësime;
- Të shpjegojë procedurat e riparimit të parregullsive të diagnostikuara ose/dhe për zëvendësime të elementëve jo funksional;

- Të përshkruajë rëndësinë e provës së kontrollit dhe testimit pas riparimit;
- Të shpjegojë procedurat e mirëmbajtjes sipas udhëzimeve të prodhuesit;

Diagnostikimi në karrocërinë e automjetit

- Të përshkruajë karakteristikat teknike dhe ndërtimin e karrocërisë së automjeteve;
- Të rendisë parregullsitë kryesore të elementeve të karrocërisë të automjetet e lehta;
- Të përshkruajë shkaqet më të mundshme të parregullsive të elementeve të karrocërisë të automjeteve;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në shasinë e automjetit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në kabinën e automjetit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në elementet e çmontueshëm të karrocërisë së automjetit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në elementët e brendshëm të kabinës së automjetit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive të aksesorëve të kabinës së automjetit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive të sinjalistikës dhe të ndriçimit në kabinën dhe karrocërinë e automjetit;
- Të përshkruajë matjet dhe kontrollet për diagnostikimin;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të të dhënave nga diagnostikimi i trupit (kabinës ose/dhe karrocërisë) së automjetit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të radhës së punës që ndiqet për riparime ose/dhe për zëvendësime;
- Të shpjegojë procedurat e riparimit të parregullsive të diagnostikuara ose/dhe për zëvendësime të elementëve jo funksional;
- Të përshkruajë rëndësinë e provës së kontrollit dhe testimit pas riparimit;
- Të shpjegojë procedurat e mirëmbajtjes së karrocërisë sipas udhëzimeve të prodhuesit;

Diagnostikimi i sistemit të ecjes dhe shuarjes së lëkundjes së automjetit

- Të përshkruajë karakteristikat teknike të sistemit të ecjes së automjeteve, funksionimin dhe ndërtimin e tyre;
- Të rendisë parregullsitë kryesore të elementeve të sistemit të ecjes të automjetet e lehta;
- Të përshkruajë shkaqet më të mundshme të parregullsive të elementeve të sistemit të ecjes të automjetet e lehta;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive të urave të automjeteve;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në balestrat dhe kundërbalestrat e automjeteve;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive të amortizatorëve të automjeteve;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive të kushinetave të rrotave të automjeteve dhe mjetet përkatëse;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në disqet e automjeteve dhe mjetet përkatëse;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në gomat e automjeteve dhe mjetet përkatëse;

- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në gjeometrinë e rrotave të automjeteve dhe mjetet përkatëse;
- Të përshkruajë matjet dhe kontrollet për diagnostikimin;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të të dhënave nga diagnostikimi i sistemit të ecjes së automjetit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të radhës së punës që ndiqet për riparime ose dhe për zëvendësime;
- Të shpjegojë procedurat e riparimit të parregullsive të diagnostikuara ose dhe për zëvendësime të elementëve jo funksional;
- Të përshkruajë rëndësinë e provës së kontrollit dhe testimit pas riparimit;
- Të shpjegojë procedurat e mirëmbajtjes së sistemit të ecjes dhe shuarjes së lëkundjes së automjetit sipas udhëzimeve të prodhuesit;

Diagnostikimi me kompjuter i parregullsive të automjetit

- Të tregojë qëllimet e përdorimit të programeve kompjuterike për diagnostikimin e automjeteve dhe përparësitë e përdorimit të tij;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe parimin e veprimit të pajisjeve kompjuterike diagnostikuese në sistemin kompjuterik të automjeteve;
- Të tregojë mënyrat e dhënies së informacionit për parregullsitë e automjetit nga sistemi i tij kompjuterik;
- Të shpjegojë mënyrën e leximit dhe interpretimit të informacionit nga sistemi kompjuterik për parregullsitë e automjetit dhe të vetë sistemit kompjuterik
- Të shpjegojë rëndësinë e interpretimit të dokumentacionit teknik për sistemin kompjuterik të automjetit;
- Të listojë masat për mosdëmtimin gjatë diagnostikimit të sistemit kompjuterik të automjetit;
- Të përshkruajë procedurat e lidhjes, të vënies në punë dhe të përdorimit të pajisjes lexuese të sistemin kompjuterik të automjetit;
- Të shpjegojë procesin e diagnostikimit me anë të kompjuterit të parregullsive në automjete;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të të dhënave nga diagnostikimi i sistemit të frenimit të automjetit;
- Të përshkruajë rëndësinë e rikthimit në gjendjen fillestare të sistemit kompjuterik të automjetit pas diagnostikimit;

Diagnostikimi/riparimi/mirëmbajtja i elementëve të komfortit dhe sigurisë së automjetit

- Të përshkruajë ndërtimin e sistemit të komfortit të automjeteve dhe funksionimin e elementeve të tij;
- Të përshkruajë ndërtimin e sistemit të sigurisë të automjeteve dhe funksionimin e elementeve të tij;
- Të rendisë parregullsitë kryesore të elementeve të sistemit të komfortit dhe sigurisë të automjeteve
- Të përshkruajë shkaqet më të mundshme të parregullsive të elementeve të sistemit të komfortit dhe sigurisë të automjeteve
- Të listojë veglat, pajisjet dhe instrumentet që përdoren për diagnostikimin e sistemit të komfortit dhe sigurisë të automjeteve;

- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në elementët e sistemit të komfortit dhe sigurisë të automjetit në përputhje me katalogun e sistemit, informacionin e prodhuesit dhe interpretimin e rezultateve;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në sistemeve e sigurisë pasive të automjetit (të tilla si airbags, paratensionuesit e rripave të sigurimit, mbajtëset aktive të kokës, stakuesit e baterive dhe lëndës djegëse etj.);
- Të shpjegojë llojin dhe funksionimin e sistemeve të pavarura të ngrohjes dhe ajrit të kondicionuar dhe rregullat përkatëse të sigurisë;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në pajisjet: e fshirëseve/larjes së xhamave të automjeteve, rregullues të dritareve, sistemet e rregullimit të sediljes dhe pasqyrës;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në sistemit e ventilimit dhe ngrohjes së kabinës së automjeteve;
- Të shpjegojë parimin funksional të një mbylljeje qendrore elektrike/elektronike dhe parimin funksional të telekomandës;
- Të përshkruajë sistemet kundra vjedhjes si dhe sensorët dhe aktivizuesit e tyre;
- Të përshkruajë matjet dhe kontrollet për diagnostikimin sipas katalogut të sistemit dhe sipas udhëzimeve të prodhuesit;
- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të të dhënave nga diagnostikimi i sistemit të frenimit të automjetit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të radhës së punës që ndiqet për riparime;
- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit dhe testimit pas riparimit.

Diagnostikimi i sistemeve të ndihmës dhe informacionit të drejtuesit të automjetit

- Të përshkruajë ndërtimin e sistemit të ndihmës të drejtuesit të automjetit dhe funksionimin e elementeve të tij;
- Të përshkruajë ndërtimin e sistemit të informacionit të drejtuesit të automjetit dhe funksionimin e elementeve të tij;
- Të rendisë parregullsitë kryesore të elementeve të sistemeve të ndihmës dhe informacionit të drejtuesit të automjetit
- Të listojë veglat, pajisjet dhe instrumentet që përdoren për diagnostikimin e të sistemeve të ndihmës dhe informacionit të drejtuesit të automjetit;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në elementët e sistemeve të ndihmës dhe informacionit të drejtuesit të automjetit në përputhje me katalogun e sistemit, informacionin e prodhuesit dhe interpretimin e rezultateve;
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në sistemet e ndihmës së drejtuesit të automjetit (të tilla si rregullimi automatik i shpejtësisë, kontrolli adaptiv i lundrimit (Adaptive Cruise Control ACC), sensorët e parkimit, asistent parkimi, asistenti i ndryshimit të korsisë dhe asistent për mbajtjen e korsisë etj.);
- Të shpjegojë mënyrën e diagnostikimit të parregullsive në sistemet e informacionit të drejtuesit të automjetit (të tilla si shfaqja e të dhënave të funksionimit dhe udhëtimit, sistemet e navigimit, sistemet multimediale, sistemeve multimediale me teknologjinë Bluetooth etj.);
- Të përshkruajë matjet dhe kontrollet për diagnostikimin sipas katalogut të sistemit dhe sipas udhëzimeve të prodhuesit;

- Të shpjegojë rëndësinë e dokumentimit të të dhënave nga diagnostikimi i sistemit të frenimit të automjetit;
- Të shpjegojë rëndësinë e përcaktimit të radhës së punës që ndiqet për riparime;
- Të përshkruajë rëndësinë e kontrollit dhe testimit pas riparimit.

Sigurimi i cilësisë së shërbimeve

- Të shpjegojë rregulloret dhe standardet ISO ndërkombëtare në lidhje me sigurimin e cilësisë së shërbimeve;
- Të shpjegojë rregulloret, normat dhe ligjet kombëtare në fuqi në lidhje me sigurimin e cilësisë së shërbimeve;
- Të shpjegojë rregulloret dhe ligjet kombëtare në fuqi në lidhje me besueshmërinë dhe sigurinë e komponentëve të automjeteve, sistemeve dhe instalimeve , si dhe kujdesin ndaj mjedisit;
- Të përshkruajë metodat për kontrollin e cilësisë;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të pajisjeve dhe pjesëve të reja dhe të përshtatshme për modelin e automjetit që do të riparohet në autoservis;
- Të shpjegojë rëndësinë e garancisë së riparimeve sipas një afat kohor ose kilometrash të përshkruar;
- Të shpjegojë rëndësinë e standardeve të sigurisë në matje;
- Të shpjegojë rëndësinë e standardeve të sigurisë gjatë përdorimit të makinerive, pajisjeve dhe instrumenteve;
- Të shpjegojë rëndësinë e simbolikës për instalimet elektrike dhe elektronike;
- Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të instrumenteve analoge dhe dixhitale për monitorim, kontroll dhe verifikim në garantimin e cilësisë së shërbimeve;
- Të përshkruajë rëndësinë e leximit dhe interpretimi të katalogëve në garantimin e cilësisë së shërbimeve;
- Të përshkruajë përdorimin dhe zbatimin e standardeve aktuale për instalimet elektrike;
- Të përshkruajë standardet e sigurisë në mënyrat e kalibrimit të elementëve dhe përdorimit të pajisjeve brenda kushteve të përcaktuara nga standardet e provës;
- Të përshkruajë standardet e sigurisë në lidhje me proceset e testimit;

Rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit në autoservis

- Të përshkruajë masat për garantimin e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e mjeteve të transportit;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
- Të përshkruajë procedurat e evakuimit, llojet e emergjencave dhe protokollet përkatëse të tyre;
- Të listojë aksidentet kryesore që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë së kryerjes së shërbimeve të mjeteve të transportit duke shpjeguar mënyrën e shmangies së tyre;
- Të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit dhe masat përkatëse për eliminimin e ndotjes;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me energjinë elektrike;

- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me ngarkesa dhe pesha të rënda;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë ngritjes dhe zhvendosjes së ngarkesave;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me pajisje fikse dhe të lëvizshme etj.;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik të ruajtjes, magazinimit dhe gjatë kryerjes së punimeve me lëngje të ndryshme (vaj, alkool, lëndë djegëse, etj.) ;
- Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me gaz;

Planifikimi dhe organizimi i punës në autoservis, dhe legjislacioni

- Të listojë funksionet dhe detyrat kryesore në një autoservis;
- Të përshkruajë strukturat organizative, rolet dhe përkrahjet e punës në një autoservis;
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit të burimeve njerëzore dhe mënyrën e ndarjes së detyrave dhe organizimi i vogël i punës në një autoservis;
- Të listojë llojet e shërbimeve në autoservis;
- Të përshkruajë format ligjore të organizimit të bizneseve në fushën e shërbimit në autoservis;
- Të përshkruajë legjislacionin e punës që lidhet me veprimtarinë në fushën e shërbimit në autoservis;
- Të përshkruajë legjislacionin tatimor që i referohet bizneseve në fushën e shërbimit në një autoservis;
- Të shpjegojë organizimin në mënyrë ergonomike të vendit të punës;
- Të listojë llojet e planeve duke përshkruar mënyrën e hartimit të tyre
- Të përshkruajë llojet e makinerive, pajisjeve, mjeteve dhe instrumenteve të punës, që përdoren në një autoservis;
- Të shpjegojë rëndësinë dhe mënyrën e hartimit të një urdhri pune
- Të shpjegojë rëndësinë planifikimit të kohës së punimeve;
- Të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të procedurave të brendshme dhe të rregullave teknike të servisit të automjeteve.

Menaxhimi i veprimtarisë në autoservis.

- Të përshkruajë parimet bazë të menaxhimit të një biznesi të vogël;
- Të analizojë format e ndryshme të sipërmarrjes në lidhje me synimet kryesore të karrierës personale, mundësitë dhe përfitimet në komunitet;
- Të shpjegojë konceptet financiare (dokumentet financiare, institucionet financiare);
- Të listojë elementët e hartimit të një buxheti;
- Të përshkruajë fazat e menaxhimit të një projekti (duke identifikuar burimet e nevojshme për një projekt të veçantë);
- Të shpjegojë rëndësinë e planifikimit dhe hartimit të grafikut të shpërndarjes kohore të punës;
- Të shpjegojë rëndësinë e mbikëqyrjes së veprimtarisë së punës së punonjësve;
- Të shpjegojë rëndësinë e vlerësimit të performancës së punonjësve dhe motivimit të tyre;
- Të përshkruajë teknikat e negociimit, menaxhimit të mosmarrëveshjeve dhe arritjes së dakordësisë mes palëve;
- Të shpjegojë praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe rëndësinë e motivimit të tyre;

- Të klasifikojë prioritetet në planin e punës;
- Të listojë burimet e nevojshme për realizimin e detyrave;
- Të shpjegojë llojet e ndryshme të materialeve, karakteristikat dhe përdorimin e tyre;
- Të shpjegojë llojet e ndryshme të mjeteve të punës, karakteristikat dhe përdorimin e tyre;
- Të përshkruajë mënyrën e llogaritjeve të tërësisë së materialeve, mjeteve të punës dhe kohës së punës;
- Të përshkruajë përgatitjen e një preventivi sipas projektit teknik;
- Të përshkruajë elementët e llogaritjes së kostos dhe çmimit të një shërbimi;
- Të përshkruajë mënyrat e blerjes së materialeve dhe pajisjeve të ndryshme;
- Të përshkruajë format dhe mënyrat e përpilimit dhe arkivimit të dokumentacioneve;
- Të përshkruajë mënyrën e regjistrimit të të dhënave për faturat dhe të përgatitjes së një oferte;
- Të listojë llojet e faturave dhe mënyrat e plotësimit të tyre;
- Të përshkruajë teknikat e marketingut;
- Të shpjegojë rëndësinë e garantimit të cilësisë së shërbimeve në autoservis;

Komunikimi dhe shërbimi ndaj klientit

- Të shpjegojë rëndësinë e pritjes dhe të akomodimit të klientëve sipas rregullave të komunikimit;
- Të shpjegojë rëndësinë e informimit të klientët për shërbimet që ofrohen në autoservis;
- Të përshkruajë format e bashkëpunimit dhe komunikimit me kolegë, eprorë dhe të tjerët;
- Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave të një komunikimi me etikë dhe profesional;
- Të argumentojë rëndësinë e dëgjimit aktiv dhe të vëmendshëm në një komunikim;
- Të listojë parimet e punës në grup dhe rëndësinë e zbatimit të tyre;
- Të argumentojë mënyrat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me të tjerët;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale të fushës;
- Të përshkruajë rëndësinë e mendimit kritik;
- Të shpjegojë rregullat e komunikimit hierarkik;
- Të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të TIK-ut në komunikim;
- Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare;
- Të shpjegojë rëndësinë e menaxhimit të stresit
- Të përshkruajë mënyrën e trajtimit dhe ruajtjes së informacionit;

SHPREHI PROFESIONALE

Diagnostikimi në sistemet elektrike, elektronike dhe mekatronike në automjete, parregullsitë kryesore dhe shkaqet e tyre.

- Të lexojë bllokskemën e sistemeve të elektrike, elektronike dhe mekatronike;
- Të përgatitë automjetin për diagnostikimin e sistemeve elektrike, elektronike dhe mekatronike;
- Të realizojë diagnostikimin e parregullsive në sistemin e furnizimit me rrymë elektrike të automjeteve;

- Të matë parametrat e rrymës elektrike në një pjesë të qarkut ose në qark të plotë me pajisjet përkatëse;
- Të kontrollojë gjendjen e përcjellësve dhe izolatorëve të rrymës elektrike;
- Të përdorë veglat, pajisjet dhe instrumentet që përdoren për diagnostikimin e sistemit elektrik, elektronike dhe mekatronik;
- Të përcaktojë parregullsitë në akumulatorët (bateritë) e automjeteve dhe shkaqet e tyre, duke përdorur metodat dhe mjetet përkatëse të diagnostikimit;
- Të përcaktojë gjendjen, parregullsitë dhe shkaqet e tyre të çelësave, rezistencave, bobinave, kondensatorëve, ndriçuesve dhe sinjalizuesve duke përdorur metodat dhe mjetet përkatëse të diagnostikimit;
- Të përcaktojë gjendjen, parregullsitë të pajisjeve treguese të parametrave mbrojtëse, komutuese, komanduese dhe rregulluese) duke përdorur metodat dhe mjetet përkatëse të diagnostikimit dhe shkaqet e tyre;
- Të përcaktojë gjendjen, parregullsitë të motorëve, gjeneratorëve e akumulatorëve etj. duke përdorur metodat dhe mjetet përkatëse të diagnostikimit dhe shkaqet e tyre;
- Të përcaktojë gjendjen, parregullsitë në transformatorëve të ndryshëm duke përdorur metodat dhe mjetet përkatëse të diagnostikimit dhe shkaqet e tyre;
- Të interpretojë simbolikën e elementëve elektronikë në mjetet e transportit;
- Të përcaktojë gjendjen e qarqeve të integruara;
